SHQIP ANGLISHT

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVIZIONE



Pg. 1

Lufta kundër piraterisë audiovizive, AMA dhe Prokuroria e Përgjithshme nënshkruajnë Memorandumin e Bashkëpunimit

Krasniqi dhe Babačić lidhin marrëveshjen përfundimtare për koordinimin ndërkufitar të frekuencave mes Shqipërisë dhe Malit të Zi



Fq. 1

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X



Fq.1

Krasniqi, në Kuvend: Mbrojtja e të drejtave të autorit kërkon kompetenca të qarta dhe siguri juridike

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, paraqiti qëndrimin e AMA-s në seancën dëgjimore në Kuvend për projektligjin "Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të"...

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së, ekipi i AMA-s zhvillon takim me ekspertin ndërkombëtar Martin Dorociak

Ekipi i Autoritetit të Mediave Audiovizive ka zhvilluar një takim me ekspertin ndërkombëtar ligjor Z. Martin Dorociak , në kuadër të përpjekjeve për forcimin e ...



Fq. 1



Fq.1

Kryetarja e AMA-s merr pjesë në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive mori pjesë në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, një tryezë ndërinstitucionale që ...

Lufta kundër piraterisë audiovizive, AMA dhe Prokuroria e Përgjithshme nënshkruajnë Memorandumin e Bashkëpunimit



Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi dhe Prokurori i Përgjithshëm, Z. Olsian Çela, nënshkruan sot Memorandumin e Bashkëpunimit për forcimin e luftës kundër piraterisë digjitale audiovizive. Ky Memorandum vjen në përmbushje të detyrimeve të AMA-s që rrjedhin nga Rezoluta e Kuvendit për vitin 2026 dhe vendos një mekanizëm të qëndrueshëm bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve. Ai parashikon identifikimin dhe dokumentimin e shkeljeve, shkëmbimin e informacionit dhe referimin e rasteve që mund të përbëjnë vepra penale, me synim një reagim më të koordinuar dhe më efikas, në respekt të kompetencave ligjore të secilit institucion. Lexo më shumë

Krasniqi dhe Babačić lidhin marrëveshjen përfundimtare për koordinimin ndërkufitar të frekuencave mes Shqipërisë dhe Malit të Zi



Nënshkruhet Marrëveshja Teknike përfundimtare për koordinimin ndërkufitar të brezit të frekuencave UHF 470–694 MHz mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, e cila përcakton parametrat teknikë dhe kushtet për përdorimin e koordinuar të frekuencave nga të dy vendet. Ajo synon shmangien e interferencave të dëmshme ndërkufitare, përdorimin më efikas të spektrit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të rrjeteve të televizionit digjital tokësor (DTT). Kjo marrëveshje u firmos nga kryetarja e AMA-s, Znj. Krasniqi dhe Z. Babačić, drejtori në detyrë i EKIP-it.
Lexo më shumë



Krasniqi, në Kuvend: Mbrojtja e të drejtave të autorit kërkon kompetenca të qarta dhe siguri juridike

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Kuvend për projektligjin "Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të", Kryetarja e AMA-s, znj. Armela Krasniqi, paraqiti qëndrimin e institucionit. Znj. Krasniqi kërkoi që projektligji të përcaktojë qartë kufijtë e kompetencave të Drejtorisë për të Drejtën e Autorit dhe mënyrën e bashkërendimit të tyre me përgjegjësitë ligjore të AMA-s.

Lexo më shumë

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së, ekipi i AMA-s zhvillon takim me ekspertin ndërkombëtar Martin Dorociak



Ekipi i Autoritetit të Mediave Audiovizive ka zhvilluar një takim me ekspertin ndërkombëtar ligjor Z. Martin Dorociak, në kuadër të përpjekjeve për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe përafrimin e kuadrit rregullator shqiptar me standardet e Bashkimit Europian. Në fokus ishin disa prej çështjeve kryesore që lidhen me zhvillimet e reja në sektorin mediatik, ndër to transparenca e influencerëve dhe reklamave, si dhe transparenca e pronësisë së medias.

Lexo më shumë



Kryetarja e AMA-s merr pjesë në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive mori pjesë në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, një tryezë ndërinstitucionale që synon forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit për promovimin e barazisë gjinore. Për Autoritetin e Mediave Audiovizive, angazhimi për barazinë gjinore lidhet drejtpërdrejt me mandatin e tij ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, shmangien e stereotipeve gjinore, respektimin e dinjitetit njerëzor dhe garantimin e një përfaqësimi të drejtë të grave dhe vajzave në përmbajtjet audiovizive.

Lexo më shumë

Vijon fushata për edukimin mediatik me nxënësit e gjimnazit “28 Nëntori” në Shkodër

Në kuadër të fushatës “Kompetencë mediatike për moshat shkollore”, Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), Znj. Armela Krasniqi, së bashku me Kryetaren e Këshillit të Ankesave, zhvilluan një takim me nxënësit e gjimnazit “28 Nëntori” në Shkodër. Në fokus ishte rëndësia e edukimit mediatik dhe sfidat që shoqërojnë përdorimin e teknologjisë dhe komunikimin në mjedisin digjital.

Lexo më shumë





Siguria kibernetike, Krasniqi: Kërcënimet hibride dhe dezinformimi kërkojnë një përgjigje të koordinuar institucionale

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, mori pjesë në panelin “Kërcënimet hibride në Shqipëri: Nga ndërhyrja e huaj dhe dezinformimi drejt një përgjigjeje të koordinuar institucionale”, organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), në bashkëpunim me Hybrid CoE. Znj. Krasniqi nënvizoi se, për Shqipërinë, kjo sfidë lidhet drejtpërdrejt edhe me procesin e integrimit europian dhe përafrimin e kuadrit ligjor e rregullator me acquis të Bashkimit Europian.

Lexo më shumë

Copyright (C) 2024 Audiovisual Media Authority. All rights reserved.
Our mailing address is:
info@ama.gov.al +355 422 33006